

DURRËS - Rreth 100 gr tritol shpërtheu në bizneset e reperit të njohur Rigels Rajku, njohur me emrin e artit "Noizy". Siç shihet në pamjet e siguruara nga Report Tv, dëmet materiale janë të mëdha në dyqanin e veshjeve dhe lokalit që ndodhen në katin e parë të të dytë të një pallati pranë zonës bregdetare të Durrësit.

Lënda plasëse është vendosur në murin e jashtëm të biznesit dhe është ndezur me ftil përçelës, thanë burimet e policisë. Shpërthimi i fuqishëm ndodhi rreth orës 04:00 të mëngjesit tregojnë banorët e pallatit, të cilët kanë pësuar dëme materiale.

LEXO EDHE:
Atentat anëtarit të 'Bandës së Niklës' Marklen Haka! U qëllua me plumb në nofull! Niset me urgjencë te Trauma! Edhe në 2019 i shpëttoi plumbave (VIDEO)

Policia bën të ditur se ambientet e butikut "Illyrian" dhe të lokalit "Rigels Shisha Lounge" janë marrë me qira nga Bashkim Rajku, babai i Noizy-t.

Burime nga Policia e Durrësit thonë se nuk kanë arritur të zbulojnë element të rëndësishëm për hetimin, pasi Noizy është treguar i referuar gjatë marrjes në pyetje. Reperi ka deklaruar se ishte në gjumë kur ndodhi shpërthimi dhe nuk e ka drejtuar gjishtin tek askush!

Dy ditë më parë Noizy dhe babai i tij u vunë në qendër të vëmendjes mediatike, pas një konflikti që patën ndaj, **Clelio Serbiano**, një personazh i njohur kryesisht për videot në rrjetin social "Tik-Tok" që gjithashtu merret me muzikë. **Video** teksta Noizy grushtonte të riun përpara lokalit të tij në zonën e Currlave, u publikua në rrjetet sociale, dhe policia i vuri në hetim në gjendje të lirë, babë e bir. Sipas asaj që ka shkruar reperi në Instagram, gjithçka ndodhi pasi Cilevio me emrin e vërtetë, Kleviol Ahmeti, i ofendoi familjarët.

Por teksta zihet me Noizyn, Kleviol Ahmeti duhej të ishte në shtëpi, pasi Gjykata e Lushnjës kishte caktuar ndaj tij masë arresti shtëpiak për posedim të lëndëve narkotike dhe armë të ftohta pa leje. Ai është vënë në pranga menjëherë pas sherrit për thyerje të masës së sigurisë, ndërsa do të hetohet edhe për përplasjen me Noizyn.

36-vjeçari nuk është i njohur vetëm për këngët. Në vitin 2014, emri i Cilevios, u përfshi në historinë e avionit Piper që u rrëzua në Divjakë teksa transportonte drogë dhe armë. Bashkë me pilotin Italian Giorgio Riformato dhe disa shqiptarë të tjerë, Cilevio u hetua dhe u dënua me 10 vite burg, por përfilloi ulje me 1/3 e dënimit pasi iu pranua gjyqimi i shkurtuar, duke u linuar në vitin 2020.





Foto nga vendi i ngjarjes



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 14:50
Një vit para sherrit me Noizyn, Cilevio ndalo babanë e tij në rrugë: O xhaxh, e ke djalin kampion! Unë jam gjuajtës nga Amerika, jam pantera që të gjëj



Kleviol Ahmeti, i njohur ndryshe si Cilevio u përfahi në sherr me reperin Noizy para disa ditësh dhe aktualisht është i arrestuar pasi shkeli masën e arrestit në shtëpi. Në rrjete sociale ishte shumë aktiv dhe në një prej videove që u bë para një viti, ndoqi babain e Noizyt, Bashkim Rajkun.

Cilevio e ndaloj për ta përshëndetur dhe pasi u largua, porcilloi shoferin e tij që të shoqëronin të atin e reperit Noizy deri në shtëpi. Ndër të tjera flet me fqinë të mëdha për Noizyn duke e cilësuar si reper që ka shkruar historinë, por më vonë u përfshinë në sherr.

"O xhaxh, po të përshëndes për qejf, edhe unë jam një nga ata që djali jot nuk e ka qejf por ti je baba edhe e ke kampion djalin, pavarësisht se ne në rrugë, unë jam Cilevio Serbiano, respektë, gjujts nga Amerika. Kupto ti ore Noizy, ishte king edhe babi jot. Edhe unë e kam king babin. Ky jam unë, pantera që të gjëj. Hape krahun të kalojë babai i Noizyt dhe unë do e ndjek eskortë, është në besën time deri te shtëpia jote se mos i ndodh gjë rrugës. Ec se do e shoqërojmë. Se mos thuash më preu në besë, më kapi babin. Jo, as nga ty nuk kam gjë, seriozisht. Të takon respekti se je reper që ke shkruajtur historinë. Kjo ishte thejesht rastësi", thotë Cilevio.

Ndërkohë në orët e para të mëngjesit të sotëm, iu vu tritol dy bizneseve të reperit Noizy që dyshohet të ketë ardhur prej sherrit të fundit.



Ora 11:08
Sherrit me Noizyn/ Kush është Cilevio, i dënuar më parë për trafik droge! Ishte mes të arrestuarve për aeroplanin që u rrëzua në Divjakë, kishte drogë dhe armë




Kleviol Ahmeti, i njohur ndryshe si Cilevio Serbiano, 36-vjeç që është arrestuar pasi theu masën e arrestit në shtëpi dhe u përfshi në sherr me reperin Noizy, dhe që dyshohet për vendosjen e tritolit në bizneset e këtij të fundit në Durrës ka qenë më parë i përfshirë në një rast trafik droge. Në vitin 2014, aeroplani i llojit Piper ishte rrëzuar në Divjakë, që po transportonte drogë dhe armë, teksa drejtohej nga piloti italian, Giorgio Riformato, ndërsa hetimet e zhvilluara zbuluan se pas këtij rrëzimi fshihej një grup kriminal i trafikut të drogës, ndër tës arrestuarit ishte edhe Ahmetaj.

Asokohe në pranga ranë disa shtetas shqiptarë si bashkëpunëtorë të pilotit italian, në mesin e të cilëve edhe Cilevio dhe u dënuan në total me 47 vite burg – reperi u dënua me 10 vjet burg. Ata ishin të bashkëpandehurit e pilotit italian, por u gjykuan në një proces të veçantë. Të gjithë këtyre personave iu ul dënimi me 1/3 nga gjyqimi i shkurtuar që kishin përfutur. Kështu, Ahmeti e kreu dënimin me burg prej gjashtë vitesh dhe doli në vitin 2020 për të vazhduar me projektet muzikore.

Ai ishte arrestuar sërisht në mars të vitit 2021 nga policia në Lushnjë, pasi është kapur duke drejtuar njëjtën pa leje drejtim, ndërsa gjatë kontrollit "u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale dy doza me lëndë narkotike cannabisa salvia dhe tre armë të ftohta (thika)". Pas kryerjes së dënimit prej 13 muajsh, Cilevio u linua nga burgu në prill të vitit 2022.



Ora 08:06
Tritoli në lokalit e Noizyt në Durrës, flet fqinji: Dëgjua shpërthim të fortë, më është dëmtuar dera e ballkonit dhe makina



Një shpërthim me tritol ka ndodhur mëngjesin e sotëm në Durrës, ku i është vendosur tritol lokalit të Rigels Rajku, i njohur si Noizy. Në një intervistë për Report Tv, fqinji tha se dëgjua një shpërthim shumë të fuqishëm, ndërsa tha se i është thyer xhami i ballkonit dhe i makinës.

"Dëgjua një krismë, u trembëm shumë. Pata dëmtim në derën e jashtme të ballkonit. Më është thyer edhe xhami i makinës."- u shpreh fqinji.



M.Q./Shqiptarja.com

TAG: rigels shisha lounge shpërthim noizy durres rigels rajku

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH ZON

Sondazhi i ditës:
A duhet që edhe Kosova t'i bashkohet nismës Ballkani i Hapur?

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Përshatit lokalit si qendër për lojërat e fatit, arrestohet 35-vjeçari në Shijak

8 Qershor, 12:51

Kronikë

Po riparonte dollapin, rrëzohet dhe humb jetën 70 vjeçari në Durrës

8 Qershor, 11:51

Politikë

Zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Zgjeruar e Bashkisë Shijak, 3 kandidatët prezantojnë platformat

7 Qershor, 19:12

Kronikë

Përshatit lokalit për prodhim të Bitcoin, arrestohet 31-vjeçari në Durrës! Sekuestrohet lokalit, 260 gr marijuanë dhe 18 pajisje për prodhimin e kriptomonedhave

7 Qershor, 15:59

Kronikë

Fushë-Krujë/ Plagosi me armë komshilun, 44-vjeçarit në kërkim i gjendet shtëpi bari e municion luftarak

6 Qershor, 18:13

Kronikë

Pëson infarkt, ndahet nga jeta Ard Daulxhiu

6 Qershor, 14:30

Kronikë

Autor i disa veshjeve në qytet, arrestohet 45 vjeçari në Durrës

6 Qershor, 11:48

Kronikë

VIDEO/ Ishte duke ujtur bimët e kanabisit, 'droni' kap mat 45-vjeçarin në Krujë! Tenton të fshihet, por arrestohet nga policia

4 Qershor, 09:16

Kronikë

Krujë/ Përfshihet nga flakët një sipërfaqe me shkurret, në afërsi të disa banesave

3 Qershor, 11:35

Sociale

Gripi i shpendëve/ Dy pulari kërkohet kompensim për putat e asgjësuar, kompanitë: Do të padisim Ministrinë e Bujqësisë

2 Qershor, 17:26

Kronikë

Sezoni veror nis me sherr për shëzlongët, u zënë për vendosjen e cadrave të plazhit në Durrës, 3 persona në hetim

2 Qershor, 13:26

Kronikë

Durrës/ 5 shoferë të arrestuar, 1326 globa dhe 24 patenta të pezulluara, Policia Rrugore bën 'bilancin' e një jave

2 Qershor, 11:44